



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0142
Data e Vendimit: 21.03.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 3 pika 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim, si dhe neni 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE Doctor Exterminator DDD Sh.P.K., kundër Njoftimit e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 21/03/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e "Doctor Exterminator" DDD Sh.P.K. me nr. të protokollit 2023/0142 , e datës 17/03/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës se Prishtinës.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës se Prishtinës, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform neni 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Autoriteti kontraktues, Komuna e Prishtinës, me datën 28. 09. 2022, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka publikuar me datën 08.03.2023 Njoftimin B54 (Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara), ku sipas këtij Njoftimi dhe dosjes së tenderit, afati i fundit për ofertim ka qenë data: 20.03.2023.

Operatori ekonomik “Doctor Exterminator” DDD Sh.P.K, kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar me datën 15.03.2023, ora 16:23minuta, që llogaritet qe kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 16.03.2023, katër (4) dite para hapjes se ofertave.

OE ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 17. 03. 2023 ka parashtruar ankesë në OSHP.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të lëndës, konform nenit 108/A paragrafi 3 pika 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrimin të kërkesave për rishqyrtim të miratuar nga KRPP-ja, Kryetarja e OSHP-së vlerëson se kërkesa për rishqyrtim e OE “Doctor Exterminator” DDD Sh.P.K është e jashtëafatshme, sepse sipas kësaj dispozite ligjore thuhet:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj, duke u bazuar në sqarimin e dhënë sipas nenit përkatës, OSHP konsideron se ankesa e OE “Doctor Exterminator DDD Sh.P.K” është e jashtëafatshme sepse e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor në autoritet kontraktues, andaj konform nenit 117 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**